

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Në kuadër të sistemit të kontrollit të brendshëm, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm, e cila përbën një mekanizëm të pavarur dhe objektiv sigurie dhe këshillimi. Njësia ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, me qëllim:

- Vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Monitorimin e menaxhimit të riskut institucional;
- Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë me kuadrin ligjor dhe rregullator;
- Evidentimin e dobësive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim;

Mekanizmat kontrollues dhe monitories realizohen përmes:

Planet strategjike dhe planet vjetore të punës

Njësia e Auditimit të Brendshëm harton Planin Strategjik të Auditimit parashikuar 3 vitet e ardhshme dhe Planin Vjetor të Auditimit për vitin pasardhës, të miratuara nga organet përkatëse drejtuese, në rastin konkret Bordi i Administrimit. Planifikimi bazohet në vlerësimin e riskut institucional dhe synon mbulimin e proceseve financiare, akademike dhe administrative me impakt të lartë në arritjen e objektivave të AP. Këto plane përbëjnë instrumentin kryesor të kontrollit sistematik dhe të orientuar mbi riskun.

Raporte monitorimi dhe auditimi

Mekanizmi i monitorimit realizohet përmes:

- Kryerjes së auditimeve të përputhshmërisë, financiare dhe të performances;
- Hartimit të raporteve të auditimit me gjetje të klasifikuara sipas nivelit të riskut;
- Dhënies së rekomandimeve konkrete për forcimin e kontrollit të brendshëm ;
- Ndjekjes periodike të zbatimit të rekomandimeve dhe raportimit mbi progresin.;

Raportet përbëjnë mjetin formal të vlerësimit të efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes.

- Hartimi dhe zbatimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Auditimit ;
- Kryerja e auditimeve të orientuara mbi riskun në fusha financiare, akademike dhe administrative;
- Klasifikimi i gjetjeve sipas nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët);
- Ndjekjes periodike të zbatimit të rekomandimeve të dhëna;
- Raportimi periodik pranë drejtimit dhe organeve përkatëse;

Përmes këtyre mekanizmave, Njësia e Auditimit të Brendshëm kontribuon në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve institucionale.

Mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe në përputhje me Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të miratuar nga Bordi i Administrimit me Vendim nr. 3174 Prot., datë 14. 10. 2024 “Për miratimin e Planit Strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm të USH-së për periudhëm 2025-2027” dhe Vendimi nr. 549/1 Prot., datë 09.02.2026 “Për miratimin e raportit vjetor të auditimit dhe pyetësorin e vëtvlerësimit për vitin 2025”, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e saj për periudhën Janar–Dhjetor 2025 e paraqitur kjo në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Realizimi i Planit Vjetor

Gjatë vitit 2025 janë planifikuar 8 auditime, nga të cilat janë realizuar 6 auditime, me një nivel realizimi prej 75%. Është kryer gjithashtu auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve. Nuk ka pasur shmangie nga plani vjetor.

Fushat kryesore të audituara

Auditimet janë fokusuar në sisteme me rëndësi financiare, akademike dhe administrative, përfshirë:

- Menaxhimin e fondeve të akorduara nga BE dhe donatorë të tjerë (projektet IPA);
- Sistemin e bursave dhe reduktimit/përrjashtimit nga tarifa e shkollimit;
- Sistemet e sekretarive mësimore (matrikullimi, dokumentacioni, arkëtimi);
- Sistemin e ngarkesave mësimore;
- Sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, përfshirë detyrimet e prapambetura.

Gjetjet dhe rekomandimet

Auditimet e realizuara gjatë vitit 2025 evidentuan se, megjithëse sistemet e kontrollit të brendshëm janë të vendosura dhe funksionale, efektiviteti i tyre nuk është gjithmonë i njëtrajtshëm në të gjitha proceset e audituara.

Gjetjet kryesore lidhen me:

- Dokumentimin e pamjaftueshëm të procedurave dhe proceseve , si dhe nevojën për përditësimin dhe formalizimin e tyre sipas kuadrit rregullator në fuqi;
- Mospërputhje në pasqyrimin dhe raportimin financiar, veçanërisht për detyrimet e prapambetura dhe rakordimet përkatëse;
- Mangësi në dokumentacionin mbështetës dhe administrimin e proceseve për përfitimet studentore, duke reflektuar nevojën për forcim të verifikimit dhe monitorimi;
- Ndarje jo të qartë të përgjegjësive dhe mungesë monitorimi të vazhdueshëm të kontrolleve, në disa procese akademike dhe administrative;
- Përqëndrim të masave të menaxhimit të riskut kryesisht në trajtimin e çështjeve të evidentuara, dhe më pak në qasjen parandaluese.

Këto çështje janë klasifikuar sipas nivelit të riskut dhe janë shoqëruar me rekomandime konkrete me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. përmirësimin e proceseve dhe rritjen e transparencës institucionale. Në përgjithësi, gjetjet theksojnë nevojën për rritje të

konsistencës në zbatim, përmirësim të monitorimit dhe forcim të mekanizmave parandalues të risku

Gjatë vitit 2025 janë dhënë gjithsej 14 rekomandime, nga të cilat:

- 11 janë pranuar plotësisht
- 3 janë pranuar pjesërisht

Sipas nivelit të riskut:

- 2 rekomandime me risk të lartë
- 9 rekomandime me risk të mesëm
- 3 rekomandime me risk të ulët

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

Nga auditimet rezulton se sistemet e kontrollit të brendshëm janë të vendosura dhe funksionale, duke ofruar një nivel të pranueshem sigurie për arritjen e objektivave institucionale. Megjithatë, efektiviteti i tyre nuk është gjithmone i njëtrajtshëm për shkak të:

- Dokumentimi i pamjaftueshëm ;
- Ndarja jo e qartë e përgjegjësiave ;
- Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm;
- Fokusit më të madh në trajtimin e problematikave sesa në parandalimin e risqeve.

Masa për përmirësim

Janë rekomanduar masa për:

- Forcimin e dokumentimit dhe përditësimin e procedurave;
- Përmirësimin e ndarjes së përgjegjësiave;
- Zbatimin e monitorimit të vazhdueshëm të rekomandimeve ;
- Integrimin e elementeve parandalues në menaxhimin e riskut;
- Trajtimin prioritar të rekomandimeve me risk të lartë dhe të mesëm;

Përfundim

Ky relacion paraqet në mënyrë të përmblëdhur dhe transparente veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, në funksion të garantimit të informimit publik mbi mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit institucional, pa cenuar të dhëna personale apo elemente konfidenciale.